



Data: \_\_\_\_\_

Numri i çështjes: \_\_\_\_\_

Emri i klientit: \_\_\_\_\_

Numri i identifikimit të klientit  
(CIN): \_\_\_\_\_

## KËRKESAT E PUNËS PËR TË RRITURIT ME AFTËSI PA PERSONA NË VARËSI ME MUAJIN E NUMËRUESHËM (ABAWD) (Albanian)

Kjo letër është për t'ju njoftuar se \_\_\_\_\_ është identifikuar si i Rritur me Aftësi Fizike pa Persona në Varësi (ABAWD). Të dhënat tona tregojnë se ai/ajo ka marrë një muaj të plotë përfitimesh të llogaritshme. Megjithatë, ai/ajo nuk i ka plotësuar kërkesat e punës të ABAWD për \_\_\_\_\_.

(MM/YYYY)

ndryshojnë për shkak të këtij njoftimi.

Për të marrë SNAP, një ABAWD duhet të përmbushë disa kërkesa pune. Individët nuk mund të marrin SNAP pa i përmbushur këto kërkesa për më shumë se tre muaj në një periudhë 36-mujore. Ky është muaji \_\_\_\_\_ i juaj i numërueshëm.

Pas muajit të tretë të llogaritur, përfitimet tuaja SNAP do të ndalen nëse nuk filloni t'i përmbushni kërkesat ose nëse nuk përjashtoheni nga kjo kërkesë. Ne do t'ju dërgojmë një njoftim të veçantë përpara se të ndërpresim përfitimet tuaja.

### SI T'I RUANI PËRFITIMET TUAJA TË SNAP:

Mund t'i mbani përfitimet e SNAP-it dhe të shmangni përdorimin e një muaji të numërueshëm, nëse i plotësoni kërkesat e punës. Ju mund ta përmbushni kërkesën e punës duke paraqitur prova se, për të paktën 20 orë në javë mesatarisht ose 80 orë në muaj, ju jeni:

- Duke punuar (duke përfshirë punën "pa kompensim" dhe punën vullnetare),
- Merrni pjesë në një program kualifikues pune/trajnimi të miratuar nga Administrata e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration, HRA),
- Merrni pjesë në një program punësimi dhe trajnimi për veteranët i drejtuar nga Departamenti i Punës (Department of Labor) ose Departamenti i Çështjeve të Veteranëve (Department of Veterans Affairs),
- Të merrni pjesë në një program sipas ligjit për Aktn e Inovacionit dhe Mundësive të Fuqisë Punëtore ose Aktin e Tregtisë, që mund të përfshijnë kërkimin për punë, gatishmërinë për punë, trajnimin për aftësitë profesionale dhe aktivitetet arsimore, **OSE**
- Të merrni pjesë në një aktivitet të lidhur me punën, të miratuar nga HRA-ja, ose duke kryer aktivitet vullnetar në shërbim të komunitetit për një numër orësh në muaj të barabartë me shumën që përfiton familja nga SNAP-i, pjesëtuar me rrogën minimale shtetërore. Ne do t'ju dërgojmë një letër të veçantë duke ju ofruar këtë mundësi.

**Shihni faqet në vijim për informacion se çfarë duhet të bëni nëse mendoni se nuk jeni ABAWD ose keni një arsye të mirë pse mund të mos keni qenë në gjendje të përmbushni kërkesat këtë muaj.**

(Ktheni faqen)

## MUAJI I NUMËRUESHËM PËR KËRKESAT E PUNËS PËR TË RRITURIT ME AFTËSI PA PERSONA NË VARËSI (ABAWD) (vazhdon)

### Si ta di nëse jam një ABAWD?

Një person i moshës 18 deri në 64 vjeç, që nuk jeton me një fëmijë nën 14 vjeç në një familje që merr SNAP dhe që konsiderohet fizikisht dhe mendërisht i aftë për të punuar, duhet të ndjekë rregullat për ABAWD-së. Nëse personi nuk i zbaton këto rregulla, ai mund të marrë përfitimet e SNAP-it vetëm për 3 muaj në një periudhë 3-vjeçare.

Ju mund të përjashtoheni nga rregullat e ABAWD nëse ndonjë nga sa vijon vlen për ju:

- Nën 18 vjeç ose 65 vjeç ose më i vjetër,
- I paaftë për të punuar për të paktën 80 orë në muaj për shkak të një gjendjeje shëndetësore fizike ose mendore,
- Anëtar i një familjeje në SNAP me dikë nën moshën 14 vjeçe,
- Shtatzënë,
- Një marrës i përfitimeve të aftësisë së kufizuar nga një burim publik ose privat, si për shembull përfitimet për aftësi të kufizuara nga Departamenti i Çështjeve të Veteranëve ose shteti i Nju-Jorkut,
- Një indian, indian urban, indian i Kalifornisë dhe/ose indian tjetër që është i kualifikuar për Shërbimet Shëndetësore Indiane, ose
- I përjashtuar nga kërkesat e përgjithshme të punës.
  - Jeni më të vegjël se 16 vjeç ose jeni 65 vjeç apo më i vjetër,
  - Ju jeni një 16 ose 17-vjeçar që nuk jeni kryefamiljar OSE që jeni në shkollë ose në një program punësimi të paktën gjysmën e kohës,
  - Ju i përmbushni kërkesat e punës për Programin e Ndhmës Financiare për Familjen,
  - Ju jeni përgjegjës për kujdesin e një fëmije nën 6 vjeç ose të një personi të paaftë,
  - Ju merrni pjesë rregullisht në një program trajtimi ndaj alkoolit ose drogës,
  - Ju aplikoni ose merrni përfitime papunësie,
  - Ju nuk jeni në gjendje të punoni për shkak të një arsyeje shëndetësore mendore ose fizike,
  - Ju tashmë punoni të paktën 30 orë në javë,
  - Ju fitoni \$217.50 (30 herë më shumë se paga minimale federale) ose më shumë në javë,
  - Jeni të regjistruar në një shkollë, program trajnimi ose kolegji të paktën gjysmën e kohës (studentët mund të jenë subjekt i rregullave të tjera të kualifikueshmërisë), **OSE**
  - Ju jeni një aplikues ose përfitues i SSI-së.

Nëse ju besoni se duhet të përjashtoheni nga zbatimi i Rregullave të ABAWD për shkak se plotësoni një ose më shumë nga kushtet e listuara më sipër, duhet të telefononi në numrin 718-SNAP-NOW (718-762-7669) për të na informuar. Mund t'ju kërkojmë të paraqisni prova.

**(Ktheni faqen)**

## **MUAJI I NUMËRUESHËM PËR KËRKESAT E PUNËS PËR TË RRITURIT ME AFTËSI PA PERSONA NË VARËSI (ABAWD) (vazhdon)**

**Po sikur t'i përmbush kërkesat e ABAWD-së, ose nëse normalisht i përmbush ato por ndodh diçka dhe nuk munda ta bëj këtë muaj?**

Duhet ta njoftoni HRA-në dhe mund t'ju duhet të na jepni prova. Prova mund të jenë fletëpagesat aktuale, një letër nga mjeku juaj, një letër nga një koordinator nga vendi ku ofroni vullnetarizëm, etj. Mund të telefononi në 718-SNAP-NOW (718-762-7669) për të na njoftuar.

### **A keni ndonjë gjendje shëndetësore mjekësore ose mendore apo aftësi të kufizuar?**

A jua bën të vështirë kjo gjendje që ta kuptoni këtë njoftim apo të kryeni veprimet që ju kërkohen nëpërmjet këtij njoftimi? A jua bën të vështirë kjo gjendje që të përfitoni shërbime të tjera në HRA? **Ne mund t'ju ndihmojmë.** Na telefononi në numrin 718-557-1399. Mund të kërkoni ndihmë edhe kur paraqiteni pranë një zyre të HRA-së. Ju gëzoni të drejtën ta kërkoni këtë lloj ndihme sipas ligjit.